



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 31 Korrik 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Valon Ramadani, Avdullah Hoti, Zafir Berisha, Ahmet Isufi, Albert Kinolli, Andin Hoti dhe Ali Lajçi.

Munguan: Verica Qeraniq dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës i Komisionit: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

Pjesëmarrësit tjerë: Ymridin Sylejmani, auditor i brendshëm në KRU “Hidroregjioni Jugor”, Rexhep Manxhuka, kryesues i Bordit të KRU “Hidroregjioni Jugor”, Besim Bajraliu, KRU “Hidroregjioni Jugor”, Vlora Spanca e Senver Morina, ZKA, Mentor Hyseni, GIZ, Drenushë Maxhuni, Koha Ditore, Adelinë Sahiti, KTV, Gentian Berbat, KDI dhe Besiana Dauti, Ekonomia Online.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 24.7.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për KRU „Hidroregjioni Jugor“ Sh.A Prizren për vitin 2017;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve për raportet e auditimit të komunave për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.7.2018

Përfundimi

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 24.7.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për KRU „Hidroregjioni Jugor“ Sh.A Prizren për vitin 2017

Kryetari njoftoi se sot është në shqyrtim raporti auditimit i Kompanisë Regjionale të Ujit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, ndërsa raportin e paraqiti Mërgim Lushtaku, deputet.

Mërgim Lushtaku, tha se e ka shqyrtuar raportin e auditimit për vitin 2017, dhe e ka bërë një përmbledhje të shkurtër për pikat e diskutimit. Për këtë çështje auditori ka dhënë opinion të kualifikuar. Te qeverisja dhe raportimi, kompania i ka zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm, kurse tek menaxhimi financiar dhe kontrolli, nevojitet ende punë. Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mosrivlerësimi i tyre që nga viti 2007, rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrë të duhur dhe kjo mund të ndikojë në prezantimin jo të saktë të pasqyrave financiare. Humbjet e ujit ishin 58%. Si rezultat i pamjaftueshëm i kontrollit të brendshëm, ka disa parregullsi si: faturimi i mbivlerësuar i konsumatorit, faturimi paushall jo sipas tarifës së përcaktuar për paushall, ndërrimi i ujëmatësit pa e regjistruar gjendjen paraprake të ujëmatësit të ujit të harxhuar etj. Shpenzimet përmes prokurimit ishin rritur për 8%, krahasuar me vitin paraprak. Ndërmarrja kishte bërë blerje të mallrave dhe shërbimeve, e ku pagesat u bë me para të gatshme.

Rexhep Manxhuka, tha që opinionin si i kualifikuar ka rrjedhur si rezultat i mosrivlerësimit të aseteve që nga viti 2007, që është bërë në mënyrë të përgjithshme për të gjitha kompanitë publike. Ne tani kemi aprovuar një rregullore të brendshme për menaxhim të aseteve e po ashtu, kemi formuar edhe një komision për vlerësim të tyre.

Avdullah Hoti, pyeti se pse janë rritur shpenzimet e tjera afariste me gjysmë milioni euro dhe shpenzimet për paga dhe mëditje me 130.000 euro. Si është tendenca e humbjeve në rrjet, a janë rritur këto humbje apo janë zvogëluar, dhe se çfarë po bëni ju në këtë drejtim?

Besim Baraliu, theksoi se në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, shpenzimet të cilat paraqiten në shpenzimet në të ardhurat të vitit aktual, këto barazohen në të hyrat nga grantet. Në lidhje me shpenzimet në paga, është e vërtetë që ka rritje të pagave, mirëpo, kjo është bërë në përputhje me planin e biznesit, kurse në lidhje me humbjet e ujit, tha se ne kemi bërë një strategji e cila ka për qëllim reduktimin e humbjeve.

Kryetari, pyeti se a ka shifra se sa investime janë bërë dhe a është bërë ndonjë matje për të ditur se sa ka rënë niveli i humbjeve pas investimeve dhe pyeti pse nuk respektohet Ligji i Prokurimit, në lidhje me rekrutimin e stafit dhe pse punësohen personat pa konkurs.

Besim Baraliu, tha se falë bashkëpunimit me donatorë, kryesisht me bankën Gjermane për Zhvillim dhe Ndërtim dhe me CDI-në, kemi investuar kryesisht në zgjerimin e rrjetit. Lidhur me prokurimin, theksoi se kanë ekzistuar raste emergjente dhe janë realizuar disa blerje.

Sa i përket rekrutimit të stafit, ai tha se kjo ka ndodhur tek disa punëtorë me kontratë mbi vepër. Kjo ka ndodhur sepse ne nuk kemi bërë një interpretim adekuat të Ligjit të Punës. Deri atëherë, është menduar se nuk duhet një procedurë e mirëfilltë sikur për pozitat tjera, kurse në lidhje me faturimin, ai tha, që ka mundësi për gabime të ndryshme, por që në vazhdimësi mundohen ti rregullojnë.

Albert Kinolli, theksoi se si qytetar i Prizrenit, ai është i kënaqur me furnizimin me ujë të pijshëm. Duke u bazuar në të gjeturat e auditorit, ka disa gjëra që kërkojnë disa sqarime. Sipas raportit, kompania në fund të vitit pati obligime të papaguara ndaj operatorëve ekonomikë, kurse pati edhe para të gatshme në dispozicion në fund të vitit.

Besim Baraliu, theksoi se këto nuk janë mjete tona por të donatorëve dhe nuk kemi mundur që ato t'i shpenzojmë.

Senver Morina, ZKA, tha se përderisa ato mjete kanë qenë në dispozicion të tyre, kanë mundur t'i shfrytëzojnë.

Ahmet Isufi, pyeti se pse nuk ka pasur rregullore për menaxhimin e pasurive dhe si i keni menaxhuar pasuritë deri më tani.

Ali Lajçi, pyeti se sa janë zbatuar rekomandimet.

Besim Baraliu, tha se në lidhje me rekomandimet, shumica e tyre janë implementuar. Rekomandimet që nuk janë implementuar, janë çështja e menaxhimit të pasurive dhe një rekomandim në lidhje me vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme apo borxheve të këqija.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që Raporti i Auditimit për KRU „Hidroregjioni Jugor“ Sh.A Prizren për vitin 2017, të mos adresohet më seancë plenare, mirëpo, Kompania duhet të përgatisë planin e veprimit dhe ta dërgojë në KMFP.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve për raportet e auditimit të komunave për vitin 2017

Kryetari, njoftoi se më 25 korrik, Komisioni së bashku me GIZ-in, mbajti një dëgjim publik, prej nga dolën edhe disa rekomandime. Dy rekomandime janë për MAPL-në, dy rekomandime për MF-në dhe një rekomandim është për MAP-in.

Përfundim

KMFP-ja, miratoi rekomandimet e dala nga dëgjimi publik i datës 25 korrik 2018, dhe u vendos që ato tu dërgohen institucioneve përkatëse.

5. Të ndryshme

Kryetari, uroi deputetët që të kalojnë pushime të këndshme, kurse gjatë verës do të tentojmë që me stafin mbështetës të bëjnë një plan konkret për punën që pritet nga muaji shtator.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj